VENDIM
Nr. 605, datë 25.10.2023

PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT FINANCIAR TË PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR MENAXHIMIN DHE PERSONAVE PËRGJEGJËS PËR ORGANET MBIKËQYRËSE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç", të pikës 3, të nenit 72, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Trajtimi financiar për administratorin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., të jetë në masën 300 000 (treqind mijë) lekë në muaj.
2. Trajtimi financiar për anëtarët e Këshillit të Administrimit, si persona përgjegjës të organeve mbikëqyrëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., që kontrollohet nga shteti, të jetë në masën e përcaktuar me vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore".
3. Trajtimi financiar i punonjësve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a., me detyra jomenaxheriale, përcaktohet në përputhje me ligjin e shoqërive tregtare dhe statutin e shoqërisë.
4. Vendimi nr. 574, datë 3.8.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.", shfuqizohet.
5. Ngarkohet Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku